



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Programi Bashkëpunimi Ndër-kufitar IPA Kosovë - Shqipëri 2010-2011

(Rishpallje) - Konkurs për vendë të lirë të punës për pozitën;

Task Manager - Sekretariati i Përbashkët Teknik, Kukës, Shqipëri (1 pozitë)

Kosova merr pjesë në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri - Kosovë 2010 - 2011 i financuar nga Bashkimi Europian. Qëllimi i programit është të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të zonave kufitare ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Për zbatimin e programit është themeluar Sekretariati i Përbashkët Teknik me staf nga Kosova dhe Shqipëria, i cili është i vendosur në Kukës, Shqipëri. Një Zyre Koordinuese (Antena) në Prizren, Kosovë.

Për të mbështetur zbatimin e Programit të BNK do të punësohet staf lokal:

- **Një Task Manager** (orar i plotë i punës) i cili do të jetë i **vendosur pranë Sekretariatit të Përbashkët Teknik në Kukës, Shqipëri**

Detyrat kryesore që do të kryhen përfshijnë:

- Detyra lidhur me menaxhimin, zbatimin, monitorimin, raportimin e Programeve BNK
- Mbështetje në lidhje me shpalljen, kontraktimin, zbatimin e skemave të Grantit për Programin e BNK-së
- Mbështetje për trajnimin e aplikantëve për grandet e financuara nën Programin e BNK;
- Dhënia e asistencës administrative dhe logjistike strukturave të përbashkëta të përcaktuara për zbatimin dhe monitorimin;
- Mbledhje raporte teknike nga përfituesit;
- Ofron asistencë teknike e logjistike ndaj Strukturës Operative dhe Komitetit të Përbashkët të Monitorimit dhe Komitetit të Përbashkët Drejtues
- Detyra të tjera lidhur me zbatimin e Programit sipas kërkesës së Drejtuesit të Sekretariatit të Përbashkët Teknik.

Kualifikimi i kërkuar

- Minimum 3 (tre) vjet përvojë pune në fushat përkatëse;
- Diplomë universitare në përputhje me fushat që mbulohen nga programi
- Njohuri të mira të gjuhës angleze
- Përvojë praktike e planifikimit dhe menaxhimit të projekteve
- Përvoja e mëhershme e punës me programet ndër-kufitare, ose programet/ projektet e BE-së do të shihet si një avantazh;
- Njohuri kompjuterike (MS Office Pro, Internet);
- Aftësi dhe interes personal për të udhëtuar në vendet fqinje dhe në zonat kufitare.

Afati i fundit për aplikim është data: 04.09.2012

Aplikantët e interesuar duhet të paraqesin:

- *Curriculum Vitae (CV) në Anglisht dhe një letër të shkruar të motivimit në anglisht*

Aplikimi duhet të dorëzohet direkt në adresën e mëposhtme:

Departamenti Administratës dhe Financave
Divizioni i Burimeve Njerëzore
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ish-Godina Rilindja, Kati 12, Prishtinë, Kosovë

Vetëm ato aplikacione që kanë mbërritur deri në datën e mbylljes në këtë konkurs do të merren në konsideratë.